

Prishtinë: 02.11.2007
Kodi i ZRRE-së: D_65_2007
Nr. I Referencës ERO/CPD_R_49_10_07

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Nenin 4.7, nenin 16.1 dhe nenin 6.1 të Rregullit mbi Shkycjet dhe Rikycjet në Sektorin e Energjisë Elektrike;
4. Ankesën e bërë nga konsumatori në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) të Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas nenit 14.1 të Rregullës mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të regjistruar me datë 28.05.2007 me numër regjistrimi 70/05.2007;
5. Kontratën për shërbime të energjisë elektrike të datës 12.08.2003;
6. Njoftimin për shkyçje të datës 31.01.2006;
7. Urdhëresën për shkyçje të datës 10.03.2006;
8. Kontratën për Rregullimin e borxhit të datës 10.03.2006;
9. Ankesën e Konsumatorit të bërë në KEK Sh.A me datë 01.06.2006;
10. Përgjigjen e KEK Sh.A në ankesën e konsumatorit për shkyçjen nga rrjeti elektrik si dhe gjobës së shqiptuar;
11. Rekomandimi i DMK bërë Bordit të ZRrE-së, në pajtim me Nenin 14.5 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë; të datës 22.10.2007 Nr. ZRrE/DMK_R_49_10_07; dhe
12. Neni 18 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 01.11.2007 morri këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Z. Vedat Konusheci nga Prishtina, (konsumator komercial - 7/02; shifra e konsumatorit DPR – 90022729), për arsyet e paraqitura në Arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

1. Konsumatori Vedat Konushefci me datë 01.06.2006 ka bërë ankesë në KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit - Departamentin për Konsumatorë lidhur me gjobën për shkyçje në arsyetimin se po atë ditë është bërë kontrata për rregullimin e borxhit.
2. KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se me datë 10.03.2006 tek konsumatori për shkak të borxhit në shumë prej 524.62 € është dhënë urdhëresa ekipit të shkyçjes për ta shkyçur konsumatorin nga rrjeti elektrik dhe se po atë ditë është ekzekutuar kjo urdhëresë me çka ekipi i shkyçjes ka vendosur edhe vulën (bllombën) me numër 10063827 dhe për këtë shërbim konsumatori është ngarkuar me gjobë prej 100.00 € plus TVSH-ja e gjitha prej 115.00 €.
3. Pas kësaj konsumatori me datë 28.05.2007 iu ka drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRë me numër regjistrimi 70/05 2007 duke e apeluar përgjigjen e KEK Sh.A lidhur me gjobën për shkyçje.
4. Konsumatori në kërkesën e tij ka kërkuar që të lirohet nga gjoba e shkyçjes të datës 10.03.2006 me të cilën e ka ngarkuar KEK Sh.A.
5. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve gjatë analizës dhe shqyrtimit të dokumentacioneve të ofruara nga KEK-u dhe nga konsumatori, ka propozuar Bordit të ZRRë-së që të refuzoj ankesën e konsumatorit me Nr. 70/05 2007 për arsye si në vazhdim:
 - 5.1 Me datë 31.01.2006 KEK-u e ka njoftuar konsumatorin me anë Njoftimit për shkyçje se duhet ta paguaj borxhin që ka ndaj KEK-ut ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ishte rreth 499.15 €, bazuar në nenin 16.1 të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë. Andaj njoftimi për shkyçje e ka ngarkuar kartelën e konsumatorit (borxhin e përgjithshëm) me shumë prej 10 € plus TVSH, pra e gjitha 11.50 €.
 - 5.2 Pasi që konsumatori nuk i ka përmbytur të gjitha aksionet e specifikuar në njoftimin për shkyçje pra, nuk ka e ka paguar borxhin e përgjithshëm apo nuk ka nënshkruar Kontratën për Riprogramim të borxhit brenda kohës sa iu është dhënë në njoftim për shkyçje, me datë 10.03.2006 me anë të urdhëresës për shkyçje është ekzekutuar shkyçja nga rrjeti elektrik nga ekipi i KEK Sh.A, bazuar në nenin 6.1 të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë dhe se kjo shkyçje e ka ngarkuar kartelën e konsumatorit prej 100 € plus TVSH, pra e gjitha prej 115 €.
 - 5.3 Konsumatori atë ditë (me datë 10.03.2006) ka nënshkruar kontratë me KEK Sh.A për shërbimet e energjisë elektrike, me çka ka marrë përsipër obligimet e konsumatorit.
 - 5.4 Me datë 10.03.2006 konsumatori ka nënshkruar me KEK Sh.A edhe Kontratën për rregullimin e borxhit në shumë prej 524.62 € për 16 këste mujore, ku kësti mujor ishte në vlerë prej 23.40 €.
 - 5.5 Bazuar në nenin 6.1 të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, ndërmarrja energjetike mund të shkyçë konsumatorin i cili nuk

paguan faturën e vet ose shumën siç përcaktohet në një marrëveshje-pagimi të lidhur me ndërmarrjen energjetike brenda afatit përfundimtarë dhe sipas kushteve të përcaktuara në dispozitën e faturës ose pagesës në përputhje me Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

- 5.6 KEK Sh.A ka vepruar në bazë të kornizës ligjore në fuqi dhe në bazë të rregullave të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji..
- 5.7 Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve duke vlerësuar ankesën e konsumatorit drejtuar ZRrE-së, përgjigjen e KEK Sh.A dhënë konsumatorit, analizimin e dëshmive të paraqitura dhe duke u bazuar në Kornizën Ligjore të Aplikueshme në Kosovë, lidhur me ankesën e konsumatorit për kontestimin ndaj gjobës së shkyçjes konstaton se nga ana e KEK Sh.A janë zbatuar të gjitha procedurat e parapara në Rregullin mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, andaj **refuzon** ankesën e konsumatorit si të pabazë.
6. Më 01.11.2007 Bordi i ZRrE-së ka mbajtur mbledhjen dhe ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që **ta refuzoj** ankesën e konsumatorit për arsye të paraqitura në pikën e 5 të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi konsumatori mund të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

Kryesuesi i Bordit

Antarët e Bordit:
